



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI I KONKURRENCËS**

Nr. 59/ Prot.

Datë 20.03.2025

18

VENDIM

Nr. 1167, Datë 20.03.2025

“Kërkesë për sigurim të dhënash nga ana e ndërmarrjes Luljeta Gjoni PF që ushtron veprimtari në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Korçë ”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 20.03.2025 ,shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Kërkesë për sigurim të dhënash nga ana e ndërmarrjes Luljeta Gjoni PF, me Nipt: L63916006R, që ushtron veprimtari në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun e Korçës.

Baza Ligjore: Nenet 24 shkronja (d), neni 33, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (ligji nr. 9121/2003).
Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës “Mbi sigurimin e të dhënave nga ana e ndërmarrjes Luljeta Gjoni PF dhe ndërmarrjes Bora Fruit SHPK në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve”

VËREN SE :

1. Komisioni i Konkurrencës, me vendimin nr. 1114, datë 04.10.2024, “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-Perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë”, vendosi hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në këtë treg, për periudhën kohore nga 1 Janar 2023 deri në 30 Shtator 2024.
2. Në vazhdim të procedurës, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës, ngriti Grupin e Punës përgjegjës për ndjekjen procedurave të këtij hetimi. Për realizimin e kësaj procedure Grupi i Punës në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 9121 datë

28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, dhe vendimit të Komisionit të Konkurrencës nr.1114, datë 04.10.2024 “Për hapjen e procedurës së hetimit të thelluar në tregun e grumbullimit dhe shitjes me shumicë të fruta-perimeve në qarkun Tiranë, Elbasan, Berat, Fier dhe Korçë”, gjatë procedurës së inspektimit të datës 20.11.2024 pranë ndërmarrjes Luljeta Gjoni PF, nëpërmjet shkresës nr. 27/147 prot., datë 18.11.2024 “Kërkesë për informacion”, ndërmarrjes i është kërkuar informacioni përkatës për qëllime të hetimit. Ky informacion është kërkuar të paraqitet sipas formatit brenda datës 06.12.2024, por ka rezultuar se informacioni nuk është dorëzuar brenda afatit të përcaktuar.

3. AK, me shkresën nr. 10 prot., datë 07.01.2025 “Ri-Kërkesë për informacion” ka rikërkuar nga ndërmarrja Luljeta Gjoni PF, që informacioni përkatës të dërgohet brenda datës 17.01.2025.
4. Në vijim, në mungesë të përgjigjes nga ana e ndërmarrjes të “Ri-kërkesës për informacion”, nëpërmjet shkresës nr. 59/6 prot., datë 04.02.2025 “Kërkesë për informacion”, nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë (DRTK), e për dijeni Luljeta Gjoni PF, është kërkuar informacioni mbi xhiron e realizuar për vitin 2023 dhe vitin 2024, si dhe pasqyrat financiare të ndërmarrjes Luljeta Gjoni PF, dhe në vazhdim konstatohet që nga DRTK dhe ndërmarrja Luljeta Gjoni PF nuk është depozituar asnjë nga informacionet e kërkuara.
5. Nga ana e Sekretariatit janë ezauruar të gjitha hapat e parashikuara për marrjen e informacionit nga ndërmarrja Luljeta Gjoni PF, pasi i është kërkuar disa here informacion me anë të shkresave zyrtare.
6. Informacioni i kërkuar nga ana e Autoritetit të Konkurrencës është shumë i rëndësishëm për procedurën hetimore, pasi përmban të dhëna të detajuara të veprimtarisë ekonomike të ndërmarrjes në tregun, për të cilën është hapur procedura hetimore.
7. Ndodhur përpara kësaj situate, të mos vënies në dispozicion të informacionit të kërkuar nga ndërmarrja, vlerësohet se nga informacioni i munguar, në fazën në të cilën ndodhet hetimi, më i rëndësishmi dhe i domosdoshëm për vazhdueshmërinë e hetimit me qëllim identifikimin e ndonjë kufizimi të mundshëm të konkurrencës sipas nenit 4 të ligjit nr. 9121, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, është vënia në dispozicion e informacionit të kërkuar.
8. Ligji nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, në neni 73, pika 1, e klasifikon mos depozitim të të dhënave brenda afatit kohor si shkelje të lehtë, e cila sanksionohet me gjobë jo më shumë se 1% të xhiros totale të vitit paraardhës financiar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24 shkronja (d) nenit 33, pika 2 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar, si dhe ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”

VENDOSI:




- I. T'i kërkojë ndërmarrjes Luljeta Gjoni PF, të depozitojë pranë Autoritetit të Konkurrencës, brenda datës 01 .04. 2025, informacionin e mëposhtëm:
1. Listën e fermerëve nga të cilët grumbulloni produktet mollë (emër, mbiemër, nr. telefoni), portokall, limon, luleshtrydhe, dardhë, qepë, presh, lakër, lulëlakër, brokoli, kastravec, patate, domate, karrotë dhe spec për periudhën kohore nga 1janar 2023 deri në 30 shtator 2024;
 2. Akt marrëveshjet e lidhura me fermerët për blerjen e produkteve mollë, portokall, limon, luleshtrydhe, dardhë, qepë, presh, lakër, lulëlakër, brokoli, kastravec, patate, domate, karrotë, spec për periudhën kohore nga 1janar 2023 deri në 30 shtator 2024;
 3. Kontratat me fermerët dhe pikat grumbulluese, kontrata me klientët dhe kontrata me ndërmarrjet që kryeni eksport për periudhën kohore nga 1janar 2023 deri në 30 shtator 2024;
 4. Blerjet analitike sipas produkteve mollë, portokall, limon, luleshtrydhe, dardhë, qepë, presh, lakër, lulëlakër, brokoli, kastravec, patate, domate, karrotë dhe spec, të ndara sipas importit dhe blerjes brenda vendit duke cilësuar sasinë, çmimin, datën dhe subjektin e blerjes (fermer dhe/ose pikë grumbulluese) për periudhën kohore nga 1janar 2023 deri në 30 shtator 2024;
 5. Shitjet analitike sipas produkteve mollë, portokall, limon, luleshtrydhe, dardhë, qepë, presh, lakër, lulëlakër, brokoli, kastravec, patate, domate, karrotë dhe spec, duke cilësuar sasinë, çmimin, datën dhe klientët përkatës për periudhën kohore nga 1janar 2023 deri në 30 shtator 2024. *(Të dhënat t'i referohen shitjeve me shumicë të produkteve dhe çmimeve pa TVSH)*;
 6. Koston analitike mesatare mujore sipas produkteve mollë, portokall, limon, luleshtrydhe, dardhë, qepë, presh, lakër, lulëlakër, brokoli, kastravec, patate, domate, karrotë dhe spec, për periudhën kohore nga 1janar 2023 deri në 30 shtator 2024;
 7. Kapacitetin magazinues të ndërmarrjes tuaj;
 8. Pasqyra financiare për vitin 2023;
 9. Xhiro e realizuar për vitin 2023;
 10. Kontrata me klientë dhe furnizues blerje shitje fermerë për periudhën kohore nga 1janar 2023 deri në 30 shtator 2024;
 11. Si caktohen çmimet e blerjes dhe shitjes, si dhe na dërgoni bashkëlidhur të gjitha njoftimet (e-mail), ku u janë komunikuar klientëve tuaj ndryshimi i çmimeve për produktet mollë, portokall, limon, luleshtrydhe, dardhë, qepë, presh, lakër, lulëlakër, brokoli, kastravec, patate, domate, karrotë dhe spec, për periudhën kohore nga 1janar 2023 deri në 30 shtator 2024.

II. Mos sjellja e këtij informacioni në afatin e caktuar shoqërohet me penalitetet përkatëse në zbatim të nenit 73, pika 1, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, i ndryshuar.

III. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA () Zv/Kryetar	Rezana KONOMI () Anëtar	Fatjola DELIJA () Anëtar	Durim KRAJA () Anëtar
			Denar BIBA () Kryetar

